

Përmbajtja

1. Cilat janë palët e përfshira në kontratat e sigurimit të Jetës?
2. Cilat janë llojet kryesore të kontratave të sigurimit të Jetës dhe për se shërbejnë ato?
3. Ngjarje e siguruar:
 - 3.1 Karakteristikat kryesore për disa nga produktet e sigurimit të jetës:
 - 3.1.1 Sigurimi i Jetës për Hua (Debitori)
 - 3.1.2 Sigurimi i Jetës me Shëndet
 - 3.1.3 Sigurimi Jetë dhe Aksidente
 - 3.1.4 Sigurimi i Jetës me Kursim/Përfitim
4. Ku mund të siguroheni
 - 4.1 Cilët janë shoqëritë e sigurimit të Jetës të cilëve mund t'u drejtohesh?
 - 4.2 Cilët janë ndërmjetësit në sigurime të cilëve mund t'u drejtohesh?
5. Si të vlerësoni përshtatshmërinë e kontratës të ofruar?
6. Detyrimi për informim
7. Format e përmbushjes së detyrimit për informim
8. Qëllimet që i ke vënë vetes
9. Kur konsiderohet e lidhur kontrata e sigurimit të Jetës?
10. Pagesa e primit të sigurimit
11. Çfare duhet të bëni për:
 - Të ndryshuar, anuluar një kontratë të sigurimit të Jetës apo përfunduar përpara afatit atë
12. Si mund të bëni një ankesë
13. Si bëhet kërkesa për dëmshpërblim
14. Legjislacioni i zbatueshëm



SIGURIMI I JETËS



Ky material informues ka për qëllim t'i shërbejë konsumatorit si një udhëzues, për t'i ndihmuar të kenë më tepër informacion përpara se të vendosin për të marrë një kontratë sigurimi të Jetës. Materiali jep informacion edhe mbi të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit.

Sigurimi i Jetës ofron mbulimin me një shumë monetare (shuma e sigurimit) për një përfitues të caktuar në rast të vdekjes, të mbijetesës ose paaftësisë (të përhershme apo të përkohshme) të siguarit.

1. Cilat janë palët e përfshira në kontratat e sigurimit të Jetës?

Në kontratat e sigurimit të Jetës, mund të përfshihen palët e mëposhtme: **siguruesi**, **personi i siguar** dhe **përfituesi**.

- **Siguruesi** është shoqëria e sigurimit e cila merr përsipër sigurimin e një rreziku nëpërmjet një kontrate sigurimi.
- **I siguruari** është personi fizik për jetën e të cilit është lidhur një kontratë sigurimi.
- **Përfituesi** është personi në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit apo që përfiton nga kjo e fundit. Përfituesi dhe personi i siguar mund të jenë i njëjti person.



2. Cilat janë llojet kryesore të kontratave të sigurimit të Jetës dhe përse shërbejnë ato?



Të gjithë jemi të vetëdijshëm se të jemi të shëndetshëm është pasuria më e çmuar por në të njëjtën kohë të gjithë jemi të ekspozuar ndaj sëmundjeve dhe rreziqeve të tjera, të cilët kërcënojnë shëndetin dhe Jetën tonë.


Para se të nënshkruhet një kontratë për sigurimin e Jetës, vlerësohet lloji i produktit që i plotëson më mirë nevojat e individit që kërkon të sigurohet. Për shembull, për të mbrojtur familjen nga problemet financiare në rast të vdekjes së personit të siguruar, është më e përshtatshme të zgjidhet një policë sigurimi që mbulon këtë ngjarje të siguruar. Në rast verifikimi të ngjarjes së siguruar (vdekja e personit të siguruar) parashikon pagesën e shumës së sigurimit në favor të familjarëve.

3. Ngjarje e siguruar

Në mënyrë të përmbledhur, ngjarje e siguruar në sigurimin e Jetës mund të jetë:

- Vdekja
- Paaftësia e përkoshme apo e përhershme
- Mbijetesa

Sigurimi i Jetës ofron edhe përfitime personale, por qëllimi kryesor është përkujdesja për ata që duam më shumë në Jetë për t'i ofruar siguri e mirëqenie për çdo situatë dhe paparashikime.



3.1 Karakteristikat kryesore për disa nga produktet e sigurimit të Jetës

3.1.1 Sigurimi i Jetës për Hua (Debitori)

Ky lloj sigurimi ofron mbulim në rast të humbjes së Jetës së personit të siguruar për shkaqe natyrore apo aksidentale. Ky sigurim është një garanci financiare si për institucionin kredidhënës ashtu edhe për kredimarrësin (personin e siguruar), duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur. Mund të ofrohet, për shembull, për personat që marrin kredi në bankë, mbron kredidhënësin dhe lehtëson familjarët nga rreziku i mosshlyrjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Në rast të verifikimit të ngjarjes së siguruar, pra humbjes së jetës, është shoqëria e sigurimit e cila merr përsipër të shlyejë shumën e pakthyer të kredisë, duke lehtësuar detyrimin financiar që do të rëndonte mbi familjarët e të siguruarit apo bashkëpronarët në biznes nga detyrimi i huamarrjes.



3.1.2 Sigurimi i Jetës me Shëndet



Ky lloj sigurimi, përveç sigurimit të Jetës mbulon edhe shpenzime mjeksore për probleme shëndetësore të paparashikuara që mund t'i ndodhin personit të siguruar, kundrejt detyrimit të pagesës së primit të sigurimit nga ky i fundit. Nëpërmjet këtij lloj sigurimi ofrohet mundësia për parandalimin dhe kurimin e problemeve shëndetësore, por gjithashtu edhe kompensimin e të ardhurave për përfituesin në rast fatkeqësie.

3.1.3 Sigurimi Jetë dhe Aksidente

Ky lloj sigurimi ofron mbrojtje financiare për të siguruarin në rast të humbjes së Jetës si pasojë e ndodhjes së ngjarjeve aksidentale, si edhe mbrojtje për paaftësi të përhershme apo të përkohshme nga po këto ngjarje.

3.1.4 Sigurimi i Jetës me Kursim/Përfitim

Ky lloj sigurimi është një mënyrë kursimi i cili parashikon pagesën e një shume monetare në fund të një afati të caktuar ose në rast fatkeqësie përgjatë periudhës së sigurimit.



4. Ku mund të siguroheni



Kontrata e sigurimit të Jetës mund të lidhet direkt me shoqërinë e sigurimit të Jetës, ose përmes ndërmjetësve në sigurime, të licencuar/miratuar nga AMF dhe të regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve në Sigurime.

Në secilin rast, kontrata e sigurimit lidhet me vetë shoqërinë e sigurimit dhe jo me ndërmjetësit në sigurime. Nëse një agent apo broker në sigurime kontakton me konsumatorët dhe propozon një takim për të prezantuar një produkt sigurimi të Jetës, konsumatorët duhet të jenë të përgatitur për këtë takim dhe të mendojnë se çfarë kanë nevojë të sigurojnë.

Përpara se agjenti apo brokeri të prezantojë produktin bëni verifikime mbi:

- Emrin, mbiemrin dhe adresën e ushtrimit të veprimtarisë
- Licencën/Vërtetimin për të ofruar këto lloj shërbimesh
- Shoqërinë e sigurimit për të cilën punon.



4.1 Cilët janë shoqëritë e sigurimit të Jetës të cilëve mund t'ju drejtohesh?

Kontratat e sigurimit të Jetës ofrohen vetëm nga shoqëritë e sigurimit të Jetës, të cilët janë persona juridikë të licencuar dhe mbikëqyrur nga AMF për të ushtruar veprimtari sigurimi të Jetës. Lista me shoqëritë e sigurimit të Jetës, të cilat ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, gjendet në faqen e internetit të AMF-së https://amf.gov.al/ts_shoqeri_sigurimi.asp



Para nënshkrimit të një kontrate sigurimi të Jetës, gjithmonë verifikoni që emri i shoqërisë së sigurimit të Jetës i përgjigjet saktësisht njëjës prej atyre që janë të listuara në faqen e internetit të AMF-së



4.2 Cilët janë ndërmjetësit në sigurime të cilëve mund t'u drejtohesh?

Ndërmjetësit në sigurime të cilëve mund t'u drejtohesh janë agjentët apo shoqëritë e agjentëve dhe brokerat apo shoqëritë e brokerimit.



Veprimtaria e Agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari.



Veprimtaria e brokerimit në sigurime përfshin të gjitha ato veprimtari si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negociimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, duke identifikuar ofertën më të mirë të sigurimit në treg për konsumatorin, duke e paralajmëruar për mangësitë apo avantazhet e produktit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të konsumatorit. Nëse është e nevojshme brokeri propozon ndryshime në kontratën e sigurimit, me qëllim mbrojtjen më të mirë të konsumatorit.

Në faqen zyrtare online: www.amf.gov.al, AMF ka publikuar listën e ndërmjetësve të licencuar/autorizuar për të kryer shërbime ndërmjetësimi.

5. Si të vlerësoni përshtatshmërinë e kontratës të ofruar?



Nëse kontaktohet një ndërmjetës (agjent apo broker) në sigurime apo punonjësi i shoqërisë së sigurimit, duhet:

- Të kërkonte t'ju shpjegojë karakteristikat kryesore të kontratës për produktet të cilat i ofron shoqëria e sigurimit;
- Të jepni informacion mbi nevojat tuaja për sigurim;
- Të prezantoni gjendjen tuaj financiare;
- Të jepni informacion mbi masën e rrezikut që jeni të gatshëm të merrni përsipër dhe mbi qëllimet që dëshironi të arrini.

Kjo do të lejojë që së bashku me ndërmjetësin në sigurime, të identifikohen nevojat e individit i cili kërkon të sigurohet për të kërkuar tek shoqëria e sigurimit produktin që përshtatet më shumë me këto nevoja.

Jini të kujdesshëm, lexoni dhe merrni informacionin dhe sqarimet e nevojshme për të kuptuar kontratën e sigurimit përpara se ta nënshkruani atë, në të kundërt mund të rrezikoni të zgjidhni një kontratë që mund të jetë e papërshtatshme për nevojat tuaja aktuale për sigurimin e Jetës apo që nuk janë në përputhje me profilin tuaj.



Duhet të keni parasysh se është në interesin tuaj të krahasoni propozimet nga shoqëri të ndryshme të cilat operojnë në tregun e sigurimit të Jetës në vend, për të garantuar një zgjedhje të informuar.

6. Detyrimi për informim

Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit në sigurime detyrohen t'ju japin me shkrim, përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit të Jetës, të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me llojin përkatës të sigurimit. Ky informacion përmban

- Të dhëna rreth shoqërisë së sigurimit, si: emri dhe adresa e shoqërisë, e degës apo ndërmjetësit, nëpërmjet të cilit po bëhet nënshkrimi i kontratës së sigurimit;
- Rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara;
- Afatet e fillimit dhe mbarimit të kontratës së sigurimit;
- Mënyrat e ndryshimit dhe përfundimit të kontratës;
- Metoda e llogaritjes të primit, afatet dhe mënyrat e pagesës së tij, pasojat e mos pagesës së primit, si dhe pjesën e primit që i korrespondon mbulimit bazë dhe shtesë;
- Procedurat e brendshme të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, si dhe strukturën përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- Kërkesat dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit apo shumës së sigurimit;
- Procedurat jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, në lidhje me kontratën e sigurimit, në përputhje me rregullat e brendshme të siguroesit, pa ndikuar në të drejtën e ankimimit në gjykatë;
- Të dhëna të përgjithshme për taksat/tatimet dhe komisionet në lidhje me kontratën e sigurimit.

Kuadri ligjor kërkon që informacioni i detajuar për kushtet e kontratës mund t'i jepet konsumatorit edhe nëpërmjet telefonit apo shërbimit të qendrës së komunikimit, por biseda telefonike duhet të regjistrohet.

7. Format e përmbushjes së detyrimit për informim

Çdo shoqëri sigurimi detyrohet të informojë të sigurvearët nëpërmjet faqes zyrtare të internetit dhe/ose me shkrim, lidhur me sigurimin e ofruar, mbulimin dhe çështje të tjera.

Informacioni duhet të jetë:

- i plotë
- i saktë
- i qartë
- lehtësisht i aksesueshëm



Konsultoni faqet *online* të shoqërive të sigurimit të cilat ofrojnë sigurimin e Jetës apo pyesni punonjës të shoqërisë ose ndërmjetësin për të marrë informacionin që Ju nevojitet.

Gjithashtu, shoqëria e sigurimit merr informacion nga ju për të përcaktuar masën dhe nivelin e rrezikut. Këtë informacion zakonisht shoqëria e mbledh nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve. Pyetjet në pyetësor janë formuluar në formatin "Po" dhe "Jo", me qëllim që të merret i gjithë informacioni i duhur, në mënyrë që policia e sigurimit të përshtatet me nevojën për sigurim të individit. Pyetësori është shumë i rëndësishëm, sepse dhe shoqëria e sigurimit të Jetës merr të gjithë informacionin që i nevojitet nga ju.

Ju duhet të plotësoni pyetësorin mbi gjendjen shëndetësore personalisht dhe me kujdes: në rast të informacionit të pasaktë ose jo të plotë mbi gjendjen aktuale të shëndetit, shoqëria e sigurimit, në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, mund të refuzojë apo zvogëlojë pagesën e dëmshpërblimit.



8. Qëllimet që i ke vënë vetes

Stabilizimi i kushteve financiare për vete dhe/ose familjarët në rast të ndodhjes së ngjarjes së siguruar.

9. Kur konsiderohet e lidhur kontrata e sigurimit të Jetës?

Kontrata e sigurimit të Jetës konsiderohet e lidhur dhe prodhon efektet e saj, kur është:

- Nënshkruar polica e sigurimit nga të dy palët dhe
- Paguar primi apo kësti i parë i tij.

Kujdesuni të merrni një kopje origjinale të policës dhe verifikoni që dokumenti nuk përmban korrigjime.

Polica e sigurimit është dokumenti që vërteton që ju keni një sigurim të Jetës të vlefshëm

10. Pagesa e primit të sigurimit

Pagesa e primit mund të kryhet në disa forma, në varësi të kontratës së sigurimit:

- Me këste;
- Për të gjithë periudhën.

Pagesa e primit mund të kryhet nëpërmjet sistemit bankar dhe/ose para në dorë.

Si dëshmi e pagesës së primit mund të jetë, dokumenti bankar i pagesës apo mandati i arkëtimit i lëshuar nga shoqëria e sigurimit me përshkrimin e pagesës së kryer.



11. ÇFARË DUHET TË BËNI PËR:

Të ndryshuar, anuluar një kontratë të sigurimit të Jetës apo përfunduar përpara afatit atë

Një kontratë e sigurimit të Jetës mund të ndryshojë, anulohet apo dhe të përfundojë përpara afatit, në varësi të ndryshimit të rrethanave bazuar në të cilat është lidhur.

Në kontratat e sigurimit të Jetës përcaktohen mënyrat për ndryshimin apo përfundimin përpara afatit të tyre. Prandaj është shumë e rëndësishme të lexoni me kujdes kushtet e kontratës, të shkruara ndoshta me gërma të vogla, përpara se ta firmosni atë, edhe pse në momentin e firmosjes së kontratës ju nuk mendoni ta ndryshoni apo ta anuloni një kontratë sigurimi.



13. Si mund të bëni një ANKESË

Nëse keni pakënaqësi apo mendoni që shoqëria e sigurimit nuk i përmbahet kushteve të kontratës, ju mund të bëni një ankesë.

Për të marrë më tepër informacion jeni të lutur të konsultoheni me materialin informues për ankesat, të lëshuar nga Autoriteti, i cili gjendet në www.amf.gov.al



14. Si bëhet kërkesa për DËMSHPËRBLIM

Në rast të vërtetimit të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit brenda afatit të parashikuar në kontratën e sigurimit, lind e drejta për të kërkuar dëmshpërblimin.

Për këtë arsye, për të përfituar shumën e dëmshpërblimit, duhet të paraqitet kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm i përcaktuar në policën e sigurimit. Bëni kujdes që kërkesa për dëmshpërblim të paraqitet brenda afateve të rëna dakord në kontratën e sigurimit, në të kundërt shoqërisë së sigurimit i lind e drejta të mos paguajë dëmshpërblimin / shumën e sigurimit. Shoqëria e sigurimit nuk e paguan dëmshpërblimin, nëse kërkesa për dëmshpërblim është kryer pas afatit 2-vjeçar nga data e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.



15. Legjislacioni i ZBATUESHËM

Kontratat e sigurimit rregullohen nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (Kreu XXIII – Sigurimi), si dhe Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Rregullat sipas të cilave shoqëritë e sigurimit përmbushin detyrimin për informimin e të siguruarve apo personave të tjerë të interesuar përcaktohen nga Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 dhe Rregullorja Nr. 36, datë 28 maj 2015 miratuar nga AMF.

